



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 95, datë 30.09.2020

MBI

MIRATIMIN PËR PRISHJEN E DETYRUAR TË NDËRTESES SË ADMINISTRATËS TË NJËSISË ADMINISTRATIVE KATUND I RI, BASHKIA Durrës, PËR SHKAK SE ËSHTË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E DATËS 26 NËNTOR 2019 DHE PËRBËN RREZIK SHUMË TË LARTË PËR JETËN DHE SHËNDETIN, DHE ËSHTË REKOMANDUAR TË PRISHET, KJO SIPAS AKTEKSPERTIZËS SË THELLUAR TË KRYER NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT TIRANË, SI DHE MIRATIMIN PËR HEQJEN NGA LISTA E VEÇANTË E PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE DHE KONTABILITETI, TË NDËRTESES SË NJËSISË ADMINISTRATIVE KATUND I RI

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjt nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, Vendimit nr. 500, datë 14.8.2001, të Këshillit të Ministrave “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM-së nr. 796, datë 11.12.2019 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, VKM-së nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, shkresës nr.1939/1 prot., datë 06.08.2020, ardhur nga Instituti i Ndërtimit Tiranë, me lëndë “Dërgim Akt Ekspertizë e Thelluar”, ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,


KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin për prishjen e detyruar të ndërtesës së administratës të Njësisë Administrative Katund i Ri, Bashkia Durrës, për shkak se është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e datës 26 Nëntor 2019 dhe përbën rrezik shumë të lartë për jetën dhe shëndetin, dhe është rekomanduar të priset, kjo sipas aktekspertizës së thelluar e kryer nga Instituti i Ndërtimit Tiranë.
2. Miratimin për heqjen nga lista e veçantë e inventarit të pronave të paluajtshme publike dhe kontabiliteti, të godinës me emërtimin “Ndërtesa e Komunës Katund i Ri”, pronë e Bashkisë Durrës.
3. Drejtoria Ekonomike, Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, në zbatim të ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, të kryejnë veprimet në librat e inventarit ekonomik, përditësimin e listës së pronave të paluajtshme dhe fshirjen në regjistrat e pasurive të paluajtshme Durrës, të pronës me emërtimin “Ndërtesa e Komunës Katund i Ri”, që me VKM nr. 500, datë 14.8.2001, ka kaluar në pronësi të Komunës Katund i Ri (sot Bashkia Durrës).
4. Toka (trualli) i liruar nga prishja e ndërtesës, e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, nëse i plotëson kushtet për rindërtim (pasi të studiohet për kushtet gjeologjike dhe sizmike), të përdoret për rindërtimin e ndërtesës së dëmtuar nga fatkeqësia natyrore.
5. Shpenzimet për shembjen e ndërtesës të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të mbulohen nga institucionet përkatëse, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, Durrës.
6. Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Shërbimeve, bazuar në Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të bashkërendojnë punën me Njësinë Zbatuese (Fondin e Zhvillimit), që administron fondet për rindërtim, që transferohen nga Këshilli i Ministrave, prej fondit të rindërtimit, për të realizuar rindërtimin e godinës, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, si dhe përfshirjen në listën e inventarit dhe dokumentacionin përkatës të ndërtesës, pas realizimit të rindërtimit.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme Ligjore dhe Drejtoria e Shërbimeve dhe Punëve Publike.

8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 30.09.2020





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS


Nr. 899/prot.
7

Durrës, më 02.10.2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK

DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 95 datë 30.09.2020 “Mbi miratimin për prishjen e detyruar të ndërtesës së administratës të njësisë administrative Katund i Ri, bashkia Durrës, për shkak se është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e datës 26 nëntor 2019 dhe përbën rrezik shumë të lartë për jetën dhe shëndetin, dhe është rekomanduar të priset, kjo sipas aktekspertizës së thelluar të kryer nga Instituti i Ndërtimit Tiranë, si dhe miratimin për heqjen nga lista e veçantë e pronave të paluajtshme publike dhe kontabiliteti, të ndërtesës së njësisë administrative Katund i Ri”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

